

## POLITIKAT E KONTABILITETIT

### Informacion i pergjithshem

Shoqeria "Eco Cleaning" shpk eshte regjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuara ne QKR. Ortaket e shoqerise "Eco Cleaning" shpk zoterohen 5% nga ortaku i shoqerise "Eco Cleaning" 2 T dhe 95% nga ortaku Alko Impex General Construction. Administrator i firmes eshte Taulant Godroli. Adresa e shoqerise dega ne Shqiperi eshte Rruga "Reshit Petrela", Kompleksi Usluga Tirane.

Shoqeria ka objekt kryesor te veprimtarise se saj sherbim i pastrimit, grumbullimit, transportit dhe seleksionimit te mbetjeve urbane permjet ndertimit te impiantit te diferencimit per qytetin e Kamzes dhe transferimi te Autoritetit Kontraktor.

Shoqeria eshte e rregjistruar ne organet tatimore dhe ka NIPT L81811019S, shoqeria ka nje numer punonjesish ne fund te vitit 2021 prej 8 vetash.

Baza e Pergatitjes dhe e politikave te rendesishme kontabile

Pasqyrat financiare te shoqerise "Eco Cleaning" shpk jane pergatitur ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te permiresuara dhe politikat e kontabilitetit ne vijim. Pasqyrat financiare jane pergatitur me modelin e kosos historike.

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon qe drejtimi te beje gjykime, vleresime dhe supozime rreth aplikimit te politikave kontabel dhe vlerave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga keto vleresime.

Vleresimet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen vazhdimisht. Rishikimet ndaj vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen ndodh rishikimi dhe periudhat e ardhshme ne rast se ky ndikon ne periudhat aktuale dhe ato te pritshme.

### Paraqitja e transaksioneve ne monedhe te huaj

Monedha funksionale e shoqerise eshte leku shqiptar, monedha e vendit ne te cilen operon Shoqeria. Pasqyrat financiare paraqiten ne monedhen funksionale, Lek.

Transaksionet ne monedhe te huaj regjistrohen me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit.

### Njohja e te ardhurave

Shoqeria realizon te ardhura nga veprimtaria e saj kryesore qe eshte punime ndertimi. Keto te ardhura njihen nenga shoqeria ne momentin e shitjes .

#### Te ardhura nga interesat

Te ardhurat nga interesat njihen kur ato maturohen. Te ardhurat nga interesat, rrjedhin nga llogarite korente ne bankat me te cilat operon shoqeria.

#### Aktivitet afatgjata materiale

Aktivitet afatgjata materiale (AAM), te cilat plotesojne kriteret si te tilla, vleresohen fillimisht me kosto blerje ose prodhimi. AAM paraqiten ne bilanc me vleren neto (minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin, nese ka).

#### Zhvleresimi i aseteve

AAM me nje jetegjatesi te percaktuar, rishikohen per humbje nga zhvlersimi, kurdohere qe ngjarje ose ndyshime ne rrethana, tregojne qe vlera e mbetur mund te mos rikuperohet. Humbja nga zhvleresimi njihet per shumen per te cilen vlera e mbetur kalon vleren e rikuperueshme.

#### Inventaret

Inventare te tjera te blera jane vleresuar me kosto blerje, ato kalojne ne shpenzime sipas konsumit te tyre.

#### Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme klasifikohen si kliente dhe debitore te tjere. Ato lindin kur shoqeria i siguron sherbime ose para, direkt nje debitori dhe nuk ka asnje qellim tregtimi te llogarive te arketueshme. Llogarite e arketueshme paraqiten ne bilanc ne aktivet aftshkurtra .

#### Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne, parate ne arke, llogarite rrjedhese dhe fondet e ngurtesuara e vendosura ne banka.

#### Tatim fitimi

Norma e aplikuar per tatim fitimi per vitin 2021 eshte 15% sipas legjislacionit fiskal ne fuqi. Ne vitin 2021, shoqeria ka llogaritur tatim fitimi ne vleren 1,593,384. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria per vitin 2021 eshte 9029,179 leke.

Shoqeria llogarit dhe paguan kontributet per sigurime shoqerore dhe shendetsore per punonjesit sipas ligjeve ne fuqi,

#### Mjete monetare

Mjetet monetare te Shoqerise dhe ekuivalentet e tyre paraqiten te detajuara ne tabelen e meposhtme:

**SHENIMET SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN E MBYLLUR NE 31 DHJETOR 2021**

**GJENDJA E LLOGARIVE SIPAS BANKAVE PARAQITET:**

Ne fund te vitit 2021 gjendja bankare eshte 2,534,964 leke si me poshte:

**Ekstraktet e bankes**

-BKT gjendje e llogarise eshte:	<b>1,316,705.26 LEKE</b>
-BKT EURO	<b>1,218,258.28 LEKE</b>

Ne fund te vitit firma kishte gjendje 10,088.26 euro te cilat u llogariten sipas kursit te kembimit 120.76 date 31.12.2021.

**Llogarite e arketueshme**

Llogarite e arketueshme perbehen nga detyrimet qe kane te tretet ndaj shoqerise .

	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Ne leke		
Kerkesa te arketueshme kliente	110,545,206	51,989,127
Te tjera (tatimore)	375,765	97,437
Te tjera (doganore)	1,876,810	1,653,058
<b>Totali</b>	<b>112,797,781</b>	<b>53,739,622</b>

**Aktive afatgjata**

AAM paraqiten ne bilanc me vleren neto (minus amortizimin e akumuluar dhe zhvleresimin, nese ka). AAM me nje jetegjatesi te percaktuar, rishikohen per humbje nga zhvlersimi, kurdohere qe ngjarje ose ndyshime ne rrethana, tregojne qe vlera e mbetur mund te mos rikuperohet. Humbja nga zhvleresimi njihet per shumen per te cilen vlera e mbetur kalon vleren e rikuperueshme.

Shoqeria per vitin 2021 ka blere mjete transporti dhe ka llogaritur amortizim per mjetet e transportit si me poshte vijon:

<b>ECO CLEANING SHPK</b>					
<b>VITI 2021</b>					
	Vlera	Blerje	Amortizimi	Shitje	VRN 2021
Mjete transporti	8,535,921	10,540,946	1,744,650	9,250,504	8,081,713
<b>TOTALI</b>	<b>8,535,921</b>	<b>10,540,946</b>	<b>1,744,650</b>	<b>9,250,504</b>	<b>8,081,713</b>

Detyrimet te tjera

Ne detyrime afatshkurtra jane detyrimet ndaj furnitoreve ne shumen 109,133,170 leke e cila eshte e analizuar dhe eshte e paraqitur ne menyre analitike .

Vlera ne shumen **814,566** leke perbehet nga :

Pagat e punonjesve ne shumen 610,984 leke

Tatimi mbi page 8,840 leke

Kontributi i sig shoq dhe shend 194,742 leke

Vlera ne shumen **1,305,959** leke perbehet nga tatim fitimi

Ne te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit ku ka interesa pjesemarrese eshte fitimi neto i aksionereve pasi eshte paguar dividenti.

#### **1. KAPITALI AKSIONAR**

Kapitali aksionar nuk ka pesuar ndryshime gjate vitit 2021 paraqitet si me poshte.

Kapitali	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Kapital i autorizuar (ne Leke)	5,000	5,000
Vlera nominale per aksion (ne Leke)	1,000	1,000
Nr. i aksioneve	5,000	5,000

#### **Te ardhurat**

Te ardhurat e Shoqerise per vitin 2021 paraqiten me poshte te detajuara sipas llojit te tyre:

#### **Ne Leke**

	Viti 2021	Viti 2020
Te ardhura nga shitja	119,014,917	113,107,233
Te ardhura te tjera	1,026,460	0
<b>Total</b>	<b>120,041,377</b>	<b>113,107,233</b>

#### **Shpenzime Materiale**

Ne leke	Viti 2021	Viti 2020
Materiale te konsumueshme	91,522,556	105,819,548
Te tjera Shpenzime	11,884,250	2,983,283

<b>Totali</b>	<b>103,406,806</b>	<b>109,970,575</b>
<b>Shpenzime Personeli</b>		
Ne Leke	Viti 2021	Viti 2020
Shpenzime per paga	3,585,818	1,822,276
Kontribute per sigurime	598,832	304,320
<b>Totali</b>	<b>4,184,650</b>	<b>2,126,596</b>

Ne vitin 2021 shoqeria ka dale me nje fitim neto ne vleren 9,029,179 leke.

**Ngjarje pas dates se raportimit**

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera pas dates se raportimit qe do te kerkonin rregullime dhe shenime shtese ne pasqyrat financiare.

17.03.2022

**ADMINISTRATORI**

**Taulant GODROLI**

